

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 135/2009

22 shkurt 2011

Në emër të popullit

AKTGJYKIM

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger në cilësinë e Kryetarit të kolegjit dhe gjyqtaret kosovare të Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Marije Ademi si anëtare të kolegjit, në praninë e Këshilltares së lartë ligjore Edita Kusari si procesmbajtëse, në lëndën penale Pkl-Kzz Nr. 135/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Kundër të pandehurit **M.H.**

I dënuar në gjykatën e shkallës së parë me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit, të datës 23 prill 2009, P. Nr. 99/09 për kryerjen e veprës penale të **Pranimit të ryshfetit**, në kundërshtim me nenin 343, paragrafin 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)

I dënuar me katër (4) muaj burgim,

Të vërtetuar me Aktgjykimin e shkallës së dytë të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (Ap-Kz 97/2009), të datës 23 tetor 2009,

Duke vepruar lidhur me Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së paraqitur nga Avokati mbrojtës në emër të pandehurit, të datës 20 nëntor 2009, të drejtuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit (P. Nr. 99/09), të datës 23 prill 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (Ap-Kz 97/2009), të datës 26 tetor 2009,

Nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nga i pandehuri dhe e parashtruar nga mbrojtja më 20 nëntor 2009 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit (P. Nr. 99/09), të datës 23 prill 2009 dhe të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (Ap. Nr. 97/2009), të datës 26 tetor 2009

Refuzohet si e pabazë

Prandaj, edhe kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të burgimit siç është paraqitur nga Mbrojtja në kuadër të Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë më 20 nëntor 2009 dhe nga ana e të pandehurit më 13 janar 2011, refuzohet si e pabazë.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

(1) Më datën 23 shtator 2008, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (PSRK) në Prishtinë, ka ngritur propozim-akuzën kundër të pandehurit (PP. Nr. 1130/08) për veprën penale të Pranimi të ryshfeti në bazë të nenit 343, par. 2 të KPK-së, duke pohuar se në muajin nëntor të vitit 2006 në Ferizaj, i pandehuri duke qenë në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, pra si person zyrtar, kishte ftuar [redacted] si palë të lëndës civile Nd. Nr. 179/05, në restorantin Ujvara dhe – para se të hynin në këtë restorant – i kishte kërkuar 5000,- € nga [redacted] nëse dëshironte ta kryente detyrën zyrtare në bazë të autorizimeve të tij ligjore në lëndën përkatëse. Sipas aktakuzës, i pandehuri pohohet të ketë thënë: “Kjo punë nuk mund të kryhet pa i dhënë 5000,-€, sepse është një lëndë e vështirë, duhet të nxirren shumë dokumente, procedura duhet patjetër të shtyhet dhe ka mundësi që puna madje as të mos kryhet”.

(2) Gjykata Komunale e Prizrenit me Aktgjykimin e datës 23 prill 2009 ka gjetur të pandehurin fajtor për veprën penale të Pranimi të ryshfeti dhe e ka dënuar të njëjtin me një burgim në kohëzgjatjen e përmendur më sipër.

(3) Pasi i pandehuri kishte paraqitur me kohë ankesë ndaj këtij Aktgjykimi, Gjykata e Qarkut të Prizrenit me Aktgjykimin e datës 20 nëntor 2009 ka refuzuar ankesën e të pandehurit si të pabazë dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit siç u përmend edhe më lart.

(4) Më 20 nëntor 2009, Avokati mbrojtës i të pandehurit paraqiti Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër të dy aktgjykimeve: atij të Gjykatës Komunale të Prizrenit dhe atij të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit duke i kundërshtuar të dytë për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale sipas nenit 403, par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe për shkak të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal.

(5) Për këtë arsye, Mbrojtja propozon miratimin e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë duke ndryshuar vendimin e formës së prerë duke shqiptuar aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit, pra duke prishur aktgjykimin dhe duke kthyer lëndën penale për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

(6) Po ashtu në nëntor 2009, i pandehuri ka dorëzuar plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke kundërshtuar kështu të dy aktgjykimet për shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit mbi procedurën penale dhe për shkeljen e Ligjit penal duke propozuar ose prishjen e të dy aktgjytimeve ose ndryshimin e tyre në dobi të të pandehurit.

(7) Me Kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, Mbrojtja ka propozuar që në përputhje me nenin 454, par. 4 të KPPK-së, të pezullojë ekzekutimin e Aktgjyimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Prizrenit, derisa të vendoset Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Kjo kërkesë me shkrim është përsëritur nga i pandehuri edhe një herë më datën 13 janar 2011.

(8) Më 22 dhjetor 2011, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) paraqitën mendimin e tyre (142/2009), duke propozuar refuzimin e tërësishëm të Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazë.

(9) Mbrojtja së bashku me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe i pandehuri edhe një herë me 13 janar 2011 paraqitën kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit në pajtim me nenin 454, par. 4 të KPPK-së.

(10) Pastaj, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (AGjE), pas kërkesës të të pandehurit dhe pas seancës dëgjimore të mbajtur më 28 prill 2010, kishte lëshuar një vendim më datën 29 prill 2010, për marrjen e lëndës nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it. Gjykata Supreme e Kosovës më datën 22 shkurt 2011 ka mbajtur një seancë të mbyllur.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton si më poshtë:

1. Pranueshmëria e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme. Kjo kërkesë është paraqitur në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 453 të KPPK-së dhe brenda afatit ligjor ashtu siç përcaktohet me nenin 452, par. 3 të KPPK-së.

2. Procedurat e zhvilluara në Gjykatën Supreme

Kolegji pranë Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë ashtu siç përcaktohet me nenin 454, par. 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar lidhur me seancën, pasi që sipas nenit 451 e deri në nenin 460 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar t'i njoftojë palët.

3. Mbi meritat e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është e pabazuar.

a. Shkeljet Esenciale të Procedurës Penale

aa. Shkeljet e pretenduara të nenit 403 paragrafit 1 të KPPK-së

Mbrojtja si dhe i pandehuri kanë kundërshtuar se dispozitivët e të dy Aktgjyqimeve, të atij të Gjykatës Komunale si dhe atij të Gjykatës së Qarkut në Prizren, janë në kundërtënie me arsyetimet përkatëse.

Po ashtu, arsyet e dhëna në këto Aktgjyqime do të ishin të paqarta dhe kundërtënie në vete. Përveç kësaj, Aktgjykimet e ankimuar nuk paraqesin arsye për faktet vendimtare dhe përveç kësaj përkitazi me këtë janë kundërtënie me përmbajtjet e shkresave të lëndës dhe provat e administruara në këtë lëndë. Kjo e fundit nuk është vlerësuar plotësisht dhe drejt.

(a) Pamjaftueshmëritë e pretenduara të arsyetimit

Në veçanti, Gjykata e shkallës së parë kishte shpallur të pandehurin fajtor për vepër penale Marrja e ryshfetit sipas nenit 343 paragrafit 2 të KPK-së, por nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me dashjen për të kryer e krimin të tillë, siç kërkohet me ligj. Përveç kësaj, gjetjet e dispozitivit përkitazi me ftesën e palës së dëmtuar [REDACTED] nga i pandehuri në restorantin “Ujvara” dhe kërkesa e të pandehurit për 5000,- € nuk do të reflektohen në arsyetim, për të cilën kjo e fundit nuk do të ofronte asnjë dëshmi mbi çështjen përkatëse. Sipas dispozitivit Gjykata e shkallës së parë kishte gjetur se koha e kryerjes së veprës penale Marrja e ryshfetit sipas nenit 343 paragrafit 2 të KPK-së ishte Nëntor 2006, kurse kjo nuk do të ishte marrë parasysh në arsyetimin se lënda e referuar civile (Nd.nr.179/05) tanimë ishte finalizuar me inspektimin e vendit të ngjarjes më 14 shtator 2006 me rezultatin se kërkesa për ryshfet do të ishte e pakuptimtë. E fundit por jo më pak e rëndësishme, Gjykata e shkallës së parë kishte tejkaluar propozimkuzën, pasi që në restorantin “Ujvara” kurrë nuk është vërtetuar kërkesa për ryshfet, gjersa në restorantin “Te Goga” i pandehuri vetëm kishte bërë shaka. Nëse merret seriozisht kjo e fundit, do të shkelte nenin 359 të KPPK-së, prandaj duke marrë parasysh këtë i pandehuri u deklarua i pafajshëm. Së fundi, sipas të dyve Mbrojtjes dhe të pandehurit, Gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 157 të KPPK-së, pasi që kishte vendosur t’i besonte vetëm një dëshmie, që është deklarata e palës së dëmtuar, që nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër. Në këtë kontekst, po ashtu ka lidhje edhe nenin 231 paragrafi 2 pika 5 e KPPK-së, pasi që Gjykata e shkallës së parë nuk kishte marrë parasysh të gjitha deklaratat e dhëna nga i pandehuri te Prokurori Publik.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se përkitazi me këtë nuk ka shkelje të Procedurës Penale, as të Neneve 157, 231, 359 e as nenit 403 paragrafit 1 të KPPK-së.

Në veçanti, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar të gjitha provat e propozuara bazuar në aktakuzë, ku aty janë marrja në pyetje e dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], ekzaminimi i kontratës mbi shitjen patundshmërisë të datës 29 dhjetor 2004 në mes [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe i propozimit për rregullimin e megjeve, të paraqitur nga [REDAKTUAR] në Gjykatën Komunale në Ferizaj më 07 korrik 2005. Përveç kësaj, aktvendimi i kësaj Gjykate Komunale në lëndën Nd.nr.179/05 i datës 14 shtator 2006 dhe i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (Ac.nr. 982/06) i datës 19 mars 2007 ishin shqyrtuar (f. 2 e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në versionin në Gjuhën Angleze).

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës gjen se **nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e nenit 359 të KPPK-së**, meqë pasi i pandehuri u deklarua i pafajshëm Gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar të gjitha provat e rëndësishme.

Duke u bazuar në këtë provë dhe në veçanti në deklaratën e palës së dëmtuar [REDAKTUAR], Gjykata e shkallës së parë gjeti se “[...] në nëntor 2006, pas ekzaminimit të vendit të ngjarjes ata shkuan së bashku me të akuzuarin [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në restorantin “Ujvara”. Para se të hynin në restorant gjersa [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ishin duke ecur përpara, [...] i akuzuari [REDAKTUAR] i tha [REDAKTUAR] “kjo punë nuk mund të kryhet pa i dhënë 5000,-€, sepse është lëndë e vështirë, duhet të lëshohen shumë dokumente, procedura duhet të vonohet e bile as puna ndoshta nuk mund të kryhet”” dhe pastaj [REDAKTUAR] kishte reaguar, “i akuzuari [REDAKTUAR] prapë u përgjigj: “nëse i jep paratë puna do të kryhet, nëse nuk i jep nuk do të kryhet” (f. 3 e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në versionin në Gjuhën Angleze).

Gjykata Supreme e Kosovës përkitazi me këtë gjen se Aktgjykimi i shkallës së parë natyrisht nuk përmend në mënyrë eksplicite se i pandehuri kishte pasur **qëllimin për të kryer veprën penale të Marrjes së ryshfetit** siç kërkohet me nenin 343 paragrafin 2 të KPK-së. Megjithatë, bëhet shumë e qartë nga gjendja faktike e përshkruar dhe e miratuar nga Gjykata e shkallës së parë se një kërkesë e tillë nuk mund të bëhet pa dashje.

Gjykata Supreme e Kosovës përveç kësaj gjen se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka bazuar Aktgjykimin e saj vetëm në deklaratën e palës së dëmtuar, e për këtë arsye po ashtu **neni 157 paragrafi 1 i KPPK-së nuk është shkelur**.

Nga i njëjti pasus i Aktgjykimit të shkallës së parë të cituar më parë, dhe përveç vlerësimit të provave vërtetuese, veçanërisht deklaratat e dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], vjen në dritë se Gjykata e shkallës së parë ka shtjelluar në hollësi çështjen e kërkesës së pretenduar të të pandehurit për të marrë ryshfet prej 5000,-€ nga [REDAKTUAR].

Dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar se ngjarja në restorantin “Goga”, të cilën i pandehuri u mundua ta përshkruajë si shaka, kishte ndodhur në vitin 2007, por se në

njërën prej këtyre ngjarjeve i pandehuri prapë i kishte kërkuar nga [REDAKTUAR] 5000,-€ me qëllim që kryhej lënda ” (f. 3 e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të datës 23 prill 2009 në versionin në Gjuhën Angleze).

Po ashtu i biri i [REDAKTUAR] dëshmitari [REDAKTUAR] kishte deklaruar se babai i tij ishte kthyer në shtëpi pas inspektimit të vendit të ngjarjes më 14 shtator 2006 dhe kishte njoftuar familjen se i pandehuri i kishte kërkuar atij 5000,-€ ryshfet (f. 3 e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të datës 23 prill 2009 në versionin në Gjuhën Angleze).

Në fund, referim i plotë i bëhet gjetjeve të Gjykatës së shkallës së dytë, ku në kontekstin përkatës të pretendimit nga i pandehuri [REDAKTUAR] se vetëm kishte bërë shaka është potencuar se “[...]se një kërkesë e tillë e bërë nga i pandehuri [REDAKTUAR] për dhuratë ishte e vërtetë e jo shaka [...]” dhe se kjo “poashtu mund të vërtetohet nga faktet e konfirmuara gjatë procedurës sikur fakti që i pandehuri [...] si gjyqtar ishte në dijeni të plotë dhe në gjendje të kuptojë dhe vlerësojë deklaratën e tij verbale drejtuar palës së dëmtuar [REDAKTUAR] për një dhuratë, kërkesë që ishte bërë tri herë nga i pandehuri [...] për të kryer punën e tij zyrtare [...]” (f. 5 në versionin në Gjuhën Angleze).

Nga kjo e fundit po ashtu vjen në dritë se të dy Gjykatat kanë marrë parasysh deklaratën e të pandehurit se ai vetëm kishte bërë shaka. Çështja, se a i ka marrë parasysh Gjykata e shkallës së parë të gjitha deklaratat e të pandehurit siç ishin dhënë te Prokurori Publik, nuk është relevante. Prandaj, **nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e nenit 231 paragrafit 2 pikës 5 të KPPK-së.**

Duke iu referuar marrjes në pyetje nga ana e prokurorit publik, neni 231 paragrafi 2 pika 5 e KPPK-së përcakton se “[...] para çdo marrjeje në pyetje, i pandehuri [...] informohet për [...] faktin se dëshmia e tij/saj mund të përdoret si provë para gjykatës”.

Kjo qartazi tregon se Gjykata nuk ishte e obliguar t’i merrte parasysh të gjitha deklaratat e të pandehurit siç ishin dhënë te Prokurori Publik. Interpretimi i Ligjit peshon edhe më shumë, pasi që i pandehuri, duke qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor, i kishte të gjitha mundësitë t qartësonte pozitën e tij në këtë lëndë. E fundit por jo më pak e rëndësishme, duhet të nënvizohet se synimi i nenit 231 paragrafit 2 pikës 5 së KPPK-së nuk është t’i lidhë gjykatat për deklaratat e mëparshme, por ta mbrojë të pandehurin edhe gjatë fazës së hershme të procedurës, duke ia bërë atij të ditur se se çkado që ai/ajo deklaron para prokurorit mund të përdoret gjithashtu si provë në gjykim.

Së fundi, Aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i bazuar në prova të papranueshme. Prandaj, **nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e nenit 403 paragrafit 1 pikës 8 të KPPK-së gjithashtu.**

(b) Pretendimi për marrjen e gabuar parasysh të kohës kur është kryer vepra penale:

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se dispozitivi e konsideron nëntorin e vitit 2006 si kohën e kryerjes së veprës penale, por që lënda civile e referuar tanimë ishte përfunduar pas inspektimit të vendit më 14 shtator 2006, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se ky pretendim është jomeritor.

Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar aktvendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj (Nd.nr. 179/05), të datës 14 shtator 2006 dhe aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (Ac.nr.982/06), të datës 19 mars 2007, që të dyja i referohen lëndës civile përkatëse. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se “aktvendimi Nd. 179/05 i Gjykatës Komunale në Ferizaj në mes të 14.09.2006 dhe 19.03.2006 nuk ishte i plotëfuqishëm” (faqe 4 e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të datës 23 prill 2009, versioni në gjuhën angleze).

(c) Pretendimi për marrjen e gabuar parasysh të vendit ku është kryer vepra penale:

Sa i përket vendit të pretenduar të kryerjes së veprës penale Marrja e ryshfetit kundërshtohet nga mbrojtja si dhe nga i pandehuri dhe gjithashtu sa i përket kualitetit të fjalës së të pandehurit se ishte vetëm shaka, referencë i bëhet asaj që tanimë është shtjelluar në këtë aktgjykim (II. 3. a. aa. Faqet 4 dhe 5).

Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu nuk e ndan mendimin e mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 157 të KPPK-së, duke e marrë në konsideratë vetëm një dëshmi të pavërtetuar. Referencë i bëhet dëshmive të marra parasysh nga gjykata, siç është theksuar më parë në këtë aktgjykim. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të secilës dëshmi individualisht, ka bërë një vlerësim të përgjithshëm siç është cekur në faqet 4 dhe 5 të aktgjykimit në versionin në gjuhën angleze.

Gjithashtu është mjaft e qartë se gjykata e shkallës së parë, në bazë të dëshmive të marra është bindur se i pandehuri e ka kryer veprën penale Marrje e ryshfetit sipas nenit 343 paragrafit 2 të KPK-së, në restorantin “Ujëvara” në vitin 2006. Prandaj, aktgjykimi është në përputhje me propozimkuzën i cili gjithashtu për këtë arsye nuk ka shkelur nenin 403 paragrafin 1 nënparagrafin 10 të KPPK-së

(d) Neglizhenca e pretenduar e gjykatës së shkallës së parë për t'i vlerësuar plotësisht të gjitha provat në dispozicion

Sa i përket pjesës së mbetur të kundërshtimeve të mbrojtjes, në veçanti se gjykata e shkallës së parë ka “neglizhuar që t'i dëgjonte dëshmitarët e rëndësishëm si ekspertët e gjeodezisë, zyrtarët ligjorë dhe dëshmitarët e tjerë” dhe se i “mungon [...]

vlerësimi i detajuar i shkresave të lëndës dhe deklaratave, duke mos i ofruar kohë të mjaftueshme të pandehurit për tu deklaruar, si dhe shkelja e parimit të publicitetit – pasi që prokurori 30 minuta para seancës së shqyrtimit gjyqësor ka hyrë në zyrën e gjyqtarit për konsultim dhe nuk ka dalë derisa ka filluar shqyrtimi, etj.”, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kjo pjesë e prezantimit të avokatit mbrojtës nuk është fare e mbështetur dhe prandaj nuk mund të merret në konsideratë më tutje.

b. Shkelja e Ligjit Penal

Mbrojtja ka theksuar se aktgjykimet e kundërshtuara shkelin ligjin penal në dëm të pandehurit. Veçanërisht, neni 404 paragrafi 1 nënparagrafi 2 i KPPK-së është shkelur pasi që rrethanat dhe dëshmitë të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit nuk janë marrë parasysht. Kjo e fundit në veçanti i referohet mungesës së dashjes së pandehurit për të kryer krimin. Gjithashtu, të dy gjykatat nuk e kanë marrë në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme se sipas të pandehurit ai vetëm kishte bërë shaka, e cila është bërë pas 14 shtatorit 2006, kur lënda civile tanimë kishte përfunduar.

Mbrojtja dhe i pandehuri, që të dy kanë theksuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur edhe nenin 1 paragrafin 3 të KPK-së në lidhje me nenet 11, 14 dhe 15 të KPK-së, që është në dëm të pandehurit për shkak të mungesës së ndonjë lidhjeje shkasore në mes të veprimeve të pandehurit dhe pasojave të veprës për të cilën akuzohet. Fakti që pala e dëmtuar si Polic, dhe i pandehuri si Gjyqtar, që të dy ishin persona zyrtarë, duke bashkëpunuar me njëri tjetrin dhe duke u takuar me njëri tjetrin në mënyrë të përhershme si dhe faktin që i pandehuri vetëm ka bërë shaka shpjen në rezultatin se nuk mund të vërtetohet asnjë lidhje shkasore në mes të sjelljes së pandehurit dhe çfarëdo rezultati penal.

Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë ka keqinterpretuar ligjin kur ka marrë mendimin se i pandehuri ka kryer veprën penale Marrje e ryshfetit në vazhdimësi.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, të dy gjykatat nuk e kanë marrë parasysht faktin se i pandehuri ishte hetuar së bashku me lëndët e tij nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Inspekcioni Gjyqësor, të cilët nuk kanë vërtetuar asnjë sjellje të pahijshme të kryer nga i pandehuri.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e adresuara nga i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës janë të pabazuara.

aa. Koha e kryerjes së veprës penale dhe përfundimi i lëndës civile:

Mbrojtja në këtë kontekst ka theksuar mendimin e tij se në kohën përkatëse (në vitin 2007) lënda civile tanimë kishte përfunduar, e që kjo e fundit ka ndodhur pas inspektimit të kryer më 14 shtator 2006, referencë i bëhet asaj që tanimë është thënë më herët në këtë aktgjykim. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë e ka bërë të qartë se “*në mes të 14.09.2006 dhe 19.03.2007*” [lënda] “*nuk kishte përfunduar*” (faqe 4 e versionit në gjuhën angleze).

Gjithashtu, duke iu referuar komentareve të ligjeve të vjetra mbi situatën, veçanërisht nenit 254 paragrafit 1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së) i cili në pjesët e tij të rëndësishme është pothuajse identik me nenin 343 paragrafin 1 të KPK-së. Kometari përcakton si në vijim:

“Vepra ekziston si e tillë edhe kur dhurata kërkohet [...] pas kryerjes apo mos kryerjes së detyrës zyrtare, që do të thotë se në mes të veprimit dhe personit zyrtar dhe kërkimit [...] të ryshfetit nuk ka lidhje shkakore. [...] Vepra penale konsiderohet e kryer me aktin e kërkimit [...] të dhuratës [...] në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e veprimit zyrtar”. (Srzentiq Nikolla dhe Ljubisha Llazareviq, komentarët mbi KP të RSFJ-së, botimi i 5-të, “Administrata bashkëkohore”, Beograd, neni 254, faqet 1 dhe 4).

Në bazë të kësaj kuptohet se përkundër faktit se lënda civile akoma ishte në zhvillim e sipër, vepra penale Marrje e ryshfetit sipas nenit 343 paragrafit 2 të KPK-së ishte kryer nga i pandehuri kur ka kërkuar shumën prej 5000 Euro nga pala e dëmtuar për përfundimin e detyrës zyrtare.

bb. Shkelja e pretenduar e nenit 1 në lidhje me nenet 11, 14 dhe 15 të KPK-së:

Sa i përket theksimit të mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 1 paragrafin 3 në lidhje me nenet 11, 14 dhe 15 të KPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se ky pretendim nuk është fare i mbështetur.

Neni 1 paragrafi 3 i KPK-së përcakton si në vijim:

Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në këtë lëndë nuk ka hapësirë për asnjë interpretim të ligjit penal në dëm të pandehurit ose – siç kërkohet me ligj në rast paqartësie - në favor të të pandehurit. Si rrjedhim, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar saktë dhe në mënyrë korrekte nenin 343 paragrafin 2 të KPK-së dhe e ka konsideruar lëndën nën kushtet e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas gjithë kësaj nuk ka asnjë dyshim se i pandehuri, duke qenë gjyqtar, ishte në dijeni të plotë për atë çfarë po vepronte dhe si do të konsiderohej kjo. Prandaj, i pandehuri pa asnjë dyshim ka përgjegjësi penale në kuptim të neneve 11, 14 dhe 15 të KPK-së, të cilët për këtë arsye nuk janë shkelur nga gjykatat.

Neni 14 i KPK-së përcakton si vijon:

Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave mungon lidhja shkakore ose kur nuk ka mundësi të shkaktohen pasojat.

Vepra penale e Marrjes së Ryshfetit sipas nenit 343 paragrafit 2 të KPK-së në versionin siç është kryer në lëndën në fjalë është përfunduar kur kryesi ka kërkuar ryshfet. Ligji përcakton si vijon:

Neni 343 i KPK-së

(1)...

(2) *Personi zyrtar i cili kërkon [...] dhuratë ose përfitim tjetër për vete [...] për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij [...] një veprim zyrtar [...] të cilin ai [...] duhet ose ka mundur ta kryejë [...] dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.*

Referencë i është bërë asaj që është thënë përpara për çështjen e lidhjes shkakore (fq.9 të këtij aktgjykimi) (shih gjithashtu: *Srzentic Nikolla dhe Ljubisa Lazarevic, Komentet në KP të RSFS, botimi i 5-të i vitit 1995, "Savremena Administracija", Beograd, neni 254, fq. 1 dhe 4).*

Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë, të dyja kanë vërtetuar se i pandehuri në disa raste por gjithmonë në rrjedhën e të njëjtës lëndë ka kërkuar ryshfet prej 5000 eurove nga pala e dëmtuar [REDAKTUAR]. Pasi që me këto kërkesa veprës penale e Marrjes së Ryshfetit në pajtim me nenin 343 paragrafit 2 të KPK-së është përfunduar asnjë lidhje shkakore ndërmjet veprimit dhe pasojës së saj nuk është duke munguar në lëndën në fjalë.

cc. Dashja e të pandehurit:

Neni 15 i KPK-së ka të bëjë me forma të ndryshme të dashjes. Në lidhje me këtë, referencë i është bërë asaj që tashmë u tha më parë në këtë aktgjykim.

Gjithashtu, deklaratat e të pandehurit që ai ka bërë vetëm shaka, kur ka kërkuar të holla nga pala e dëmtuar, është marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë, që tashmë është vënë në pah në këtë aktgjykim. Kjo mund të kuptohet nga fakti që aktgjykimi përkatës në arsyetimin e tij shprehimisht përcakton: *"Gjithashtu i akuzuari [REDAKTUAR] deklaroi se në restorantin "Goga" ai në shaka i tha [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] "a janë paratë gati" (fq.2 të versionit në gjuhën angleze). Gjykata e shkallës së parë më vonë përsëri i referohet situatës përkatëse, duke përcaktuar: "Ndërsa në restorantin "Goga" derisa [REDAKTUAR] ishte i ulur në tavolinë me të akuzuarin [REDAKTUAR] i cili shoqërohej me [REDAKTUAR], i akuzuari [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] drejtua me shaka [REDAKTUAR]: "Të kam thënë dhe po të them përsëri se pa mi dhënë mua 5000 euro, lënda nuk mund të përfundohet" (fq.3 të versionit në*

gjuhën angleze). Gjykata e shkallës së parë pastaj vazhdon me analizat e deklaratës së dëshmitarit [REDAKTUAR] që ka të bëjë me situatën përkatëse.

Nga e gjithë kjo, e lidhur së bashku me vlerësimin e provave të proceduara nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë në mënyrë serioze e ka marr parasysh deklaratën e të pandehurit lidhur me situatën në restorantin “Goga” në vitin 2007.

dd. Keqinterpretimi i pretenduar i ligjit nga gjykata e shkallës së dytë:

Sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj në mënyrë të gabueshme përfundon se vepra penale ishte kryer në vazhdimësi, përderisa asnjë provë apo dëshmi nuk është administruar në lidhje me kërkesën për rryshfet në restorantin “Ujvara”, edhe pse atje të pranishëm ishin edhe persona të tjerë. Gjykata e shkallës së dytë sa i përket kësaj në veçanti do të ngatërrojë procedurën jashtë kontestimore me procedurën e ekzekutimit të lëndës përkatëse civile.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se mbrojta i referohet paragrafit vijues të aktgjykimimit të kundërshtuar:

“[...] më vonë gjatë vitit 2007, i pandehuri [REDAKTUAR] në mënyrë të vazhdueshme ka ndërmarr aktivitete inkriminuese të veprës, kështu që derisa ata ishin së bashku në restorantin e lartpërmendur së bashku me palën e dëmtuar [REDAKTUAR] për veprimet e vazhdueshme të të pandehurit, Prokurori i autorizuar nuk ka ndërmarr masa lidhur me ndjekjen penale, dhe muaji nëntor i vitit 2006 është marrë si kohë e kryerje së veprës penale [...]” (fq.3 të versionit në gjuhën angleze).

Kjo mund të shpie në konstruksionin siç është formuluar në nenin 48 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), i njohur si “vepër e vazhdueshme penale”. Sipas komenteve përkatëse, vepra e vazhdueshme penale përbëhet në lëndët kur kryesi kryen një numër të veprave penale identike në vazhdimësi, dhe të cilat veprime për shkak të elementeve duke i lidhur ato në një tërësi, shfaqen si një vepër penale në bashkim” (Srzentic Nikolla dhe Ljubisa Lazarevic, Komentet e Kodit Penal të IRJ-së, viti 1982, “Savremena Administracija”, Beograd, neni 48, pika 6.b.).

Ekzistimi i veprës së vazhduar penale ishte konsideruar thjesht si një çështje faktike.

Megjithatë, nga paragrafi i cituar i aktgjykimimit të kundërshtuar sqarohet se gjykata e shkallës së dytë e ka parë aspektin e vazhdimësisë dhe ndoshta e ka marrë këtë si opinion ligjor. Megjithatë, gjykata ka konsideruar që vepra e vazhdueshme penale kurrë nuk është përndjekur. Prandaj, ky paragraf i aktgjykimimit të kundërshtuar nuk ka pasur kurrfarë ndikimi në vendimin e lëndës në fjalë.

ee. Kërkesa për GjSK të marr parasysh gjetjet e Inspeksionit Gjqësor të KGJK-së:

Sa i përket çështjes së fundit të Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se gjykata e shkallës së parë, siç është konfirmuar nga gjykata e shkallës së dytë, ka vlerësuar të gjitha provat që janë paraqitur në mënyrë të rregullt nga prokurori dhe në një mënyrë të dyja gjykatat kanë qenë të obliguara të bëjnë këtë. Bazuar në këtë provë, i pandehuri është shpallur fajtor. Prandaj, gjetjet e Inspeksionit Gjqësor mund të konsiderohet si një tregues ose si provë rrethanore. Në këtë aspekt vlen të përmendet që sipas letrës së Zyrës së Prokurorit Diciplinor të datës 23 shkurt 2010 dhe që i është drejtuar [REDAKTUAR], Inspeksioni Gjqësor ka gjetur sjellje të pahijshme të pandehurit në lëndët 1302/06 dhe 179/05, në të cilën e fundit është lënda përkatëse civile në fjalë. Procedurat disiplinore kundër të pandehurit janë ndërprerë vetëm për shkak se i pandehuri nuk punon më si gjyqtar, por do të merrej parasysh në rastin nëse ai do të aplikonte përsëri. Megjithatë, çështja e hetimeve të inspeksionit gjyqësor ishte theksuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, mirëpo kjo nuk është e domosdoshme që të merret në konsideratë.

Sa i përket propozimit të mbrojtjes në këtë kontekst, që Gjykata Supreme mund të kërkojë raport special nga Këshilli Gjqësor i Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet vendimit të saj të pandryshueshëm në bazë të të cilit asnjë provë nuk është marrë në këtë fazë të procedurës.

c. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është e pabazuar prandaj edhe refuzohet.

Si pasojë, Gjykata Supreme e Kosovës vendos mbi Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë si në dispozitiv, në pajtim me nenin 456 të KPPK-së.

Anëtare e kolegjit

Emine Mustafa

Kryetar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi

Procesmbajtëse

Edita Kusari